

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik AS Tech SH.P.K.; Shkelqimi Invest SH.P.K., TRINGË SMAJLI – PRISHTINË Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	11.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **10.07.2023**, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik AS Tech SH.P.K.; Shkelqimi Invest SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE – Lot IV – RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE**, me Numër të prokurimit: **623-23-2282-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-028-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik AS Tech SH.P.K.; Shkelqimi Invest SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE – Lot IV – RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE**, me Numër të prokurimit: **623-23-2282-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-028-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **04.07.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II.** Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE – Lot IV – RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE**, me Numër të prokurimit: **623-23-2282-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-028-2-1-1**
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik AS Tech SH.P.K.; Shkelqimi Invest SH.P.K. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE – Lot IV – RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE**, me Numër të prokurimit: **623-23-2282-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-028-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **04.07.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **10.07.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Arsyeja e eliminimit të ofertës sive sipas AK-së është se nuk e kemi plotësuar si duhet kërkesën për dëshmitë e kërkuara për stafin profesional, ju keni thënë që ne oferte kemi dorëzuar listën si dhe vendimin për menaxherin e projektit dhe udhëheqësin e punishtes por nuk kemi dorëzuar dëshminë si CV, Diplomen dhe kontratën. Ofertat jone dhe tenderi nuk është vlerësuar si duhet përderisa AK nuk e ka respektuar nenin 10 të Udhëzuesit nr 001/2023 i prokurimit publik: Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

LPP thotë që AK mund të kërkojë sqarime për dokumentet ekzistenciale para hapjes, ne kemi dorëzuar Listën e puntoreve dhe Vendimet për menaxher të projektit dhe udhëheqës se punishtes por për shkak të vëllimit të dokumentacionit për shkak të kapacitetit të kufizuar të ngarkimit të dokumenteve në sistem dhe kohës së shkurtër nuk i kemi ngarkuar dokumentet tjera, ekzistenca e të cilave ka datuar edhe atë ditë por që kemi qenë të vetëdijshëm se AK pastaj mund të kërkojë sqarime, siq bëjnë të gjitha AK tjera.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj ankimor nuk qëndron dhe është i pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku nuk e keni plotësuar këto kriter sipas Njoftimit për Kontrate/Dosjes së tenderit

Në bazë të pretendimit tuaj, keni cekur se AK mund të kërkojë sqarime **për dokumentet ekzistenciale para hapjes**, po ashtu keni cekur se *ne oferte kemi dorëzuar listën si dhe vendimin për menaxherin e projektit dhe udhëheqësin e punishtes por nuk kemi dorëzuar dëshminë si CV, Diploma dhe kontrata.*

Në bazë të neni 10, të Udhëzuesit nr. 001/2023, në si Autoritet Kontraktues, kemi mundur të kërkojmë sqarime shtesë, për Diplomën e Inxhinierëve dhe për CV-në e Inxhinierëve;

Por duke u thirrur ne nenin 10 të Udhëzuesit, nuk kemi mundur te kërkojmë sqarime shitesë për Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt të Inxhinierëve dhe Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit, **Ku dokumentet në fjale nuk mund te kerkohet ne baze te Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive;**

Po ashtu në Listën e Stafit të prezantuar, ne atë Listë janë prezantuar edhe Inxhinieret por ne Listë ceket qe Inxhinieret nuk janë me kontratë të rregullt pune por janë vetëm te angazhuar, ku ne si AK nuk mund te thirremi ne Nenit 10 të Udhëzuesit për plotësimin e këtyre dokumenteve pasi qe nuk mund te verifikohen në mënyrë objektive, posaqarisht marrëveshja mbi angazhim ne ketë projekt, andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

LISTA E STAFIT

Ne kompania AS TECH SH.P.K me këtë deklaratë,në lidhje me tenderin RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET PUBLIKE Nr i prokurimit 623-23-2282-2-1-1 Deklarojm ,se kemi staf te mjaftushem per kete procedur te tenderimit. Ne qëndrojm me vetëdije të plotë prapa këtij obligimi apo garancioni dhe si të till e nënshkruajm pa as një hezitim.

Lista e Stafit					
Nr	Emri dhe Mbiemri	Kualifikimi	Pozita në kompani	I rregullt/aktiv	Pervoja
1	Valdet Sadiki	Mekanik	Mekanik	I rregullt	7
2	Bekim Sadiki	Elektricitist	Elektricitist	I rregullt	7
3	Jetmir Sadiku	Serviser I paisjeve shtepiake	Serviser	I rregullt	5
4	Daut Sadiku	Serviser I paisjeve shtepiake	Serviser	I rregullt	5
5	Fahri Sadiku	Teknik Serviser I paisjeve shtepiake	Serviser	I rregullt	12
6	Bekim Mustafa	Inxhinier i Ndertimtaris-Konstruktiv	Inxhinier i Ndertimtaris	I angazhuar	7
7	Fatos Sahatqija	Inxhinier i Arkitektures	Inxhinier i Arkitektures	I angazhuar	7
8	Afrim Sadiku	Jurist	Jurist	I rregullt	9
9	Shkelqim Fetahaj	Fasader	Fasader	I rregullt	5
10	Gezim Zeqiri	Moler	Moler	I rregullt	5
11	Shpetim Xhemaj	Fasader	Fasader	I rregullt	6

Person i autorizuar:



PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

AK Komuna e Rahovecit nuk ka qene e interesuar te vleresoj oferten me te lire por ka kaluar tek oferta me e shtrenjte e cila eshte e papergjegjshme siq e vleresuar nga qasja qe e patem ne dokumentacion te saj.

OE me i shtrenjte i rekomanduar per loto 4 Konzorciumi Milazim bala dhe Bajram Gashi, nuk kan oferte te pergjegjshme sepse fillimisht OE Bajram Gashi nuk e ka plotesuar si duhet deklaraten nen betim, OE e ka plotesuar Deklaraten me daten 02.05.2023 ndersa hapja e ofertave ka qene me daten 23.05.2023.

Nje oferte nuk eshte e pergjegjshme kur nuk plotesohet si duhet deklarata nen betim e cila eshte kusht administrativ.

OE e ka nenshkruar deklaraten nen betim ne kohen kur procedura endee ka pasur korigjime dhe pas nenshkrimit te deklarates nen betim AK perseri ka derguar Njoftim per korigjim. Ky e bene te pavlefshem oferten sepse OE ka dhen deklarate nen betim per oferte n e tij ndersa pas ketij nenshkrimi AK ka bere ndryshime dhe OE nuk ka dhene nenshkrim-zotim se eshte i pergjegjshem pas ketyre korigjimeve.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesit nr. 001/2023, dhe ne asnjë rregullore nuk ceket apo nuk shkruan se me cilën datë duhet te plotësohet Deklarata nen betim nga ana e Operatorit Ekonomik, ceket për Sigurimin e tenderit qe duhet te ketë validitet nga data e hapjes, por nuk ceke për Deklaratën nen Betim

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Grupi i OE Milazim bala dhe Bajram Gashi kane dhene cmime abnormalisht te larta ne disa pozicione qe ata kane pasur informacion se mund te shfrytezohet me shume.

Nese i krahasojme cmimet e disa pozicioneve kyqe te ofertes se tyre me oferten tone ka dallime jashtzakonisht te medha-substanciale.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, nuk ka përmbushur asnjë Kusht sipas Nenit 11 të Udhëzuesit Nr. 001/2023 Për Prokurimin Publik per Tenderat Jo-Normalisht te Ulet apo abnormalisht te larte ne krahasim me ofertën e juaj

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitive të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit